



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM



RAPORT VJETOR ***2014***

*Bëj diferencën përmes synimit të përsosmërisë
në auditim*

Tiranë, Janar 2015

Përmbledhje

Ky raport përfshin aktivitetin dhe performancën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave për vitin 2014, kundrejt objektivave kryesore vjetore dhe strategjike.

Zyra jonë:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
++355 42248642

Përmbajtja

- ☐ Drejtoria jonë
- ☐ Strategjia
- ☐ Aktivitetet për vitin 2014. Zbatimi i Planit Vjetor
- ☐ Performanca e punës audituese
- ☐ Statusi i zbatimit të rekomandimeve
- ☐ Gjetjet kryesore
- ☐ Përdorimi i burimeve të auditimit
- ☐ Objektivat 2014

☐ Drejtoria jonë

Vizioni ynë

Bëj diferencën përmes synimit të përsosmërisë në auditim

Misioni ynë

Të ndihmojmë Ministrin e Financave të mbajë lart përgjegjshmërinë e qeverisjes në përdorimin e fondeve publike.

Vlerat tona

Qëllimi– të kemi një impakt, të jemi të përgjegjshëm dhe të punojmë si një skuadër.

Stafi– ne besojmë dhe respektojmë punën e të tjerëve, dhe kemi njëqasje të balancuar në kryerjen e punës.

Profesionalizmi– ne njihemi për pavarësi, integritet dhe vlerat që përcjellim.

Klientët tanë më kryesorë

Drejtorja e Auditimit të BrendshëmFinancave Raporton Ministrinë



Klientët/agjensitë

Ministria e Financave (Buxheti,Thesari, Borxhi, Shërbimet Mbështetëse, Drejtimi i Pronës, etj)

Sistemi fiskal dhe doganor
Shoqëria e Sigurimeve INSIG
Shoqëria e Parë Financiare për Zhvillim
Shtypshkronja e Letrave me Vlerë
Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
Njësia e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit
Agjencia e Auditimit të Fondeve të BE
Agjencia e Trajtimit të Kredive
Inspektorati Qendror
Inspektorati iKontrollit tëDeklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

Kush jemi ne

Drejtorja e Auditimit e Ministrisë së Financave është autoriteti ligjor i krijuar sipas ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”,i ndryshuar, e cila realizon auditime për Ministrinë e Financave me qëllim që ta ndihmojë atë në dhënien e një sigurie relative për të gjitha fushat e veprimtarive të financave publike që mbulon, si përgjegjegjshmëri e qeverisjes në përdorimin e burimeve publike.

Çfarë ne duam

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm si përgjegjëse për auditimin e shërbimeve publike të juridiksionit të Ministrisë së Financave, kryen auditime financiare, të pajtueshmërisë, së sistemeve, performancës, kështillimit, etj, në përputhje me rregullat në fuqi në fushën e auditimit të brendshëm, dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

Ne japim opinion të pavarur mbi veprimtaritë e audituara, dhe identifikojmë nëse ato janë zhvilluar në përputhje me rregullat në fuqi, nëse paratë e taksapaguesve janë shpenzuar me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet, si dhe në pajtim me ligjin.

Në auditime specifike ne përqijemi të vlerësojmë sistemin e kontrollit të brendshëm, duke konfirmuar nëse rregulla specifike, ligje, direktiva, rregullore, etj, krijojnë një sistem te fortë të kontrollit të brendshëm, ose nëse ato duhen përmirësuar.

Burimet tona

Mungesa e stafit për vitin 2014, me dy auditues, ka sjellë pengesë në përmbushjen e kërkesave për cilësi të punës audituese, si dhe ka krijuar arsye për të përdorur burimet ekzistuese me efikasitet të lartë për të përmbushur planin vjetor të auditimit. Në disa raste, janë rekrutuar ekspertë të jashtëm për të realizuar objektivat e auditimit.

E gjithë trupa audituese është e certifikuar dhe i është nënshtruar kualifikimeve të vijueshme, duke krijuar një arsye të shëndoshë për besim, profesionalizëm, integritet dhe përkushtim.

□ **Strategjia**

Vizioni Strategjik

Rritja e rëndësisë së auditimit, duke i kthyer rreziqet në rezultate

Misioni strategjik

Të mbështesë ministrin e Financave për të mbajtur përgjegjshmërinë qeverisëse në përdorimin e burimeve publike, përmes zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Prioritetet Strategjike

Ne kemi një fokus strategjik 5-vjeçar. Për periudhën 2014-2019, kemi caktuar strategjitë për të arritur qëllimet tona të pritshme. Qëllimet për secilën strategji, si dhe veprimet mbështetëse janë të detajuara përgjatë planifikimit të aktiviteteve audituese.

Prioritetet strategjike në nivel vjetor janë realizuar, si një bazë e mirë për strategjinë 5- vjeçare.

Qëllimet Strategjike

Qëllimi ynë është të realizojmë vetëvlerësimin e eficiencës së drejtimit të financave publike, duke kontribuar në shtimin e vlerës së tyre dhe forcimin e sistemit të kontrollit mbi to, duke e asistuar në mënyrë të vijueshme ministrin e Financave, si titullari i institucionin përgjegjës të shtetit shqiptar në këtë fushë.

Për këtë qëllim, ne shohim nga e ardhmja duke synuar që të aplikojmë metodologjitë dhe teknikat më të mira bashkëkohore për të përmirësuar planifikimin për auditim, maksimizimin e kapaciteteve të skuadrës audituese, dhe zgjerimin e mbështetjes në arritjen e objektivave të Ministrisë dhe sektorëve në vartësi të saj.

Ndryshimi i imazhit të këtij shërbimi është një tjetër synim të cilin kërkojmë ta arrijmë në terma afatshkurtër, duke informuar publikun dhe aktorë specifikë, mediat, etj, për të përcjellë perceptimin se ky shërbim profesional dhe i pavarur, së pari është në shërbim të mbrojtjes së interesave të tyre.

Deklarata e Misionit Strategjik

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm do të arrijë që brenda 4 vitesh;

- 1) Të jetë në gendje të shndërrojë totalisht veprimtarinë audituese të orientuar nga vlerësimi i riskut dhe nga dobia për menaxhimin.
- 2) Të modernizojmë shërbimin e auditimit duke synuar kompetencë të lartë, objektivitet maksimal dhe standarde të larta etike.
- 3) Të arrijmë të prodhojmë programe specifike të konsulencës për menaxhimin e lartë, për të gjitha fushat e financave publike.

Prioritete kyçe

Prioritetet kryesore strategjike i janë referuar rritjes së eficiencës së burimeve të auditimit, të orientuara nga analiza periodike e marrëdhënies burime të përdorura- produkte konkrete.

Për këtë, janë përcaktuar 4 prioritetet kryesore si vijon:

- 1) Përmirësimi i procesit të vlerësimit të rreziqut;
- 2) Zgjerimi i aftësive për të monitoruar rreziqet emergjente;
- 3) Qënia më të dobishëm me impakt konkret në arritjen e objektivave të organizatës;
- 4) Reduktimin e kostove të auditimit pa kërcënuar mbulimin e fushave me risqe më të larta.

Objektivat strategjike dhe aktivitetet për arritjen e tyre

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka parashikuar 3 objektiva kryesore strategjike, si dhe veprimet konkrete për realizimin e tyre në terma afatshkurtër.

Nëpërmjet tyre është synuar të arrihet të ketë një shërbim auditimi bashkëkohor të nivelit ndërkombëtar, duke gjetur edhe mundësi për t'u pajisur me certifikatë të këtij niveli.

Modernizimi i metodologjisë së vlerësimit të rreziqeve, si dhe i teknikave të auditimit, do të realizohet bazuar në një plan specifik afatmesëm trajnimesh vetëm në këto dy fusha.

Objektivat strategjike	Veprimet për t'u ndërmarrë	Afati	Produkti
Realizimi i i auditimeve të plota për të certifikuar fushat me rrezikun më të lartë në sistemin e financave publike	Krijimi i një sistemi të evidentimit të rreziqeve të kategorizuara sipas rëndësisë për sejcilën veprimtari që mbulon Ministria e Financave	2014	Regjistri i rreziqeve Metodologji të vlerësimit të risqeve
Përmirësimi i metodave dhe teknikave të auditimit, duke zbatuar ato bashkëkohore, dhe të orientuara nga metodat shkencore (ekonometrike ose statistikore)	Rishikimi i metodave të auditimit që i përkasin specifikisht sistemit të financave publike	2015	Udhërrëfyes i përditësuar

Certifikimi i audituesve sipas standardeve ndërkombëtare	Të aplikohet për fonde që të paktën dy auditues të marrin certifikatën e IIA	2016	Të paktën 2 certifikata ndërkombëtare
--	--	------	---------------------------------------

Strategite ku bazohet veprimtaria e vitit 2014:

- 1) Shpërndarja e vlerave përmes profesionalizimit në auditim.
- 2) Zbatimi i modeleve dhe strukturimi i auditimit për të demonstruar shtimin e vlerës së parasë publike.


□ Aktivitetet e planifikuara për vitin 2014. Zbatimi i planit vjetor

Është realizuar plani i auditimeve për vitin 2014. Janë kryer 66 auditime gjithsej; 56 të filluar gjatë vitit dhe 10 në proces nga viti i mëparshëm. Në numrin total përfshihen 32 misione auditimi dhe 34 për zbatimin e rekomandimeve.


Janë shpallur të përfunduara 53 auditime të filluara gjatë vitit, ndërsa 3 janë në proces.

Janë kryer 8 misione auditimi me kërkesë të menaxhimit, për të cilat është rishikuar plani vjetor.

Situata e realizimit të planit të auditimeve paraqitet:



Statusi i auditimeve në fund të vitit 2014, paraqitet:




Burimet e auditimit janë menaxhuar me eficiencë dhe në funksion të realizimit të planit vjetor duke u kujdesur për kostot e auditimit.

Janë rialokuar burimet e planifikuara për shkak të mungesës së stafit me dy auditues, si dhe të 8 kërkesave shtesë të menaxhimit. Nga 34 auditime për zbatim të rekomandimeve, shumica e tyre ose 22 i takojnë auditimeve të kryera gjatë vitit 2013, ndërsa 12 atij raportues.

□ Treguesit e performancës së auditimit

Nga analiza e treguesve më specifikë të auditimit, rezulton se ato kanë ndryshuar në vite, të ndikuara si nga numri i auditimeve, ashtu dhe nga specifikat e njësive të audituara për secilin vit respektiv, apo fushat nën auditim. Disa nga treguesit më kryesorë janë:


a) Treguesit rekomandime/auditime



Vitet	Auditime të mbyllura	Rekomandime	Rek/Auditim
2011	84	416	5.0
2012	55	349	6.3
2013	62	257	4.1
2014	63	257	4.1

b) Gjetjet e auditimit në vlerë:

Gjetjet e auditimit në vlerë i përkasin, parregullsive, abuzimeve, menaxhimit pa efektivitet të fondeve, përvetësime të pa drejta të parave publike, etj, sipas të cilave janë adresuar rekomandimet e auditimit për; i) ndreqje të parregullsive; ii) çdëmtim; iii) përmirësim të menaxhimit; iv) kallëzim penal. Ecuria e gjetjeve në 4 vitet e fundit në nivel 12-mujor paraqitet si vijon (në mijë lekë):



Konstatohet rritje e konsiderueshme e zbulimeve në vlerë, në vitin 2013 dhe kryesisht vitin raportues, ku rritja është me rreth 11.6 herë

Nga totali i zbulimeve rreth 53% e vlerës, është raportuar si dëm për buxhetin e shtetit, në të cilin pjesën më të madhe e zë zbulimi i vlerës së paguar tepër për blerjen e kredisë Sindikale me çmimin më të lartë ndër të gjithë ofertat. Kjo vlerë, si dhe zbulimet e tjera në fushën e menaxhimit të borxhit publik (me rreth 7 miliardë), kanë bërë që gjetjet në vlerë për vitin raportues të rezultojnë me njëkapërcim të lartëkrahësuar me vitet e para.

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike, çdëmtimin e vlerave për dëme të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht, si dhe arsyetimin e dyshimeve në rastet e veprave penale për abuzime, shpërdorime apo vjedhje të pronës publike.

c) Masa disiplinore për personat përgjegjës.

Janë evidentuar përgjegjësitë e zyrtarëve përgjethet e auditimit, ndaj të cilëve janë rekomanduar si vijon;

A- Masa disiplinore	Në nr.
Gjithsej	84
Nga këto: largime nga puna	6
masa të tjera	13
filluar ecuri disiplinore	29
në kompetencë të titullarëve për të analizuar përgjegjësitë	36
B- Kallëzime penale	
Gjithsej	4
Nga këto; zyrtarë publikë	12
autorë të tjerë	3

□ Zbatimi i rekomandimeve të auditimit

Drejtorja e Auditimit e ka konsideruar një nga sfidat e saj ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre, si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara, që ato të shërbejnë për ndreqjen e parregullsive e gabimeve, dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Këtë e bën duke u përpjekur që:

- 1) Të përmirësojë cilësinë e rekomandimeve dhe të risëdobinë e tyre për njësinë e audituar.
- 2) Të risë bashkëpunimin me njësinë e audituar, me synim që rekomandimet të diskutohen dhe pranohet paraprakisht, duke rënë dakord për zbatimin e tyre.
- 3) Të kërkojë respektimin e afatit ligjor të raportimit të masave të marra nga subjekti.
- 4) Të kërkojë caktimin e një zyrtari përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin e realizimit të tyre.

Brenda 6 muajsh nga adresimi i tyre, është kryer puna për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit, për t'u siguruar se njësitë kanë ndërmarrë të gjitha masat korrigjuese ose veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve dhe këshillave të auditimit. Gjatë vitit 2014 janë ndërmarrë 34 angazhime auditimi (përfshirë 6 të mbartura) për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve që kanë plotësuar afatin kohor, në të cilat vërehet se përgjithësisht njësitë e audituara kanë bashkëpunuar me grupet e auditimit, por jo në të gjitha rastet subjektet publike ngarkojnë një anëtar të stafit për ndjekjen e procesit dhe raportimit të rekomandimeve. Auditimet për zbatimin e rekomandimeve kanë qenë fokusuar në:

- Sigurimin që, sistemi i bashkëpunimit të ndjekjes së rekomandimeve të auditimit është i dokumentuar në mënyrën e duhur.
- Sigurimin që, është kthyer përgjigje në kohën e duhur, si dhe janë ndërmarrjen veprimet korrigjuese në zbatim të rekomandimeve.
- Zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lidhen me çështjet e auditimit.

Për sa më sipër ka rezultuar se;

Vetëm 14 nga 63 njësi të audituara nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 30 ditor për planin e veprimit në zbatim të rekomandimeve, ndërsa të tjerat janë në proces ose brenda afatit. Këto njësi për të cilat janë dhënë 103 rekomandime, janë;

- Drejtorja e Tatim Paguesve të Mëdhenj,
- DPT për Auditimin e i IT,
- Drejtorja e Borxhit në MF,
- Shtypshkronja e Letrave me Vlerë,
- Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga BE
- Drejtorja e Borxhit (auditimi i Kredisë Sindikale),
- Dega e Thesarit Tropojë,
- Dega e Thesari Fier,
- Dr. Shërbimeve në MF (auditimi i karburantit),
- NJMLF (zbatimi i rekomandimeve),
- MF, Dr. Shërbimeve (prokurimet-zbatimi i rekomandimeve);
- AAPA (auditimi dhe zbatim rekomandimeve).


- DRT, Tiranë, (zbatim rekomandimesh),
- DR e Tatimpaguesve Paguesve të Mëdhenj (zbatim rekomandimesh).

Në 7 nga 14 subjekte publike të mësipërme, është kryer procesi i verifikimit të rekomandimeve (87 rekomandimet takuese), nga ku ka rezultuar se, edhe pse nuk është kthyer përgjigje, janë realizuar në fakt 56 (nga 87 të verifikuarat), ndërkohë që për diferencën (31) është kërkuar rivendosja e tyre.

Janë pranuar menjëherë nga njësitë e audituara 235 rekomandime nga 257 gjithsej ose 91.5% e tyre. Nga 22 të refuzuara, edhe pse palët nuk kanë rënë dakord, drejtimi ka vendosur zbatimin e tyre, si rrjedhim 12 kanë rezultuar të realizuara nga verifikimi, duke e çuar në 96.1 nivelin e zbatimit të tyre.

Është raportuar disa herë shqetësimi i njësisë së auditimit për mos marrjen në shqyrtim dhe mos zbatimin e rekomandimeve të adresuara në auditimin e Agjencisë së Auditimit të Fondeve të Asistencës Akredituar nga BE, të cilat rezultojnë ende të tilla deri në përfundim të periudhës raportuese- Dhjetor 2014.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve deri në mbyllje të periudhës së raportimit paraqitet si vijon:



Veprimtaria audituese

Aktiviteti i drejtorisë është bazuar mbi zbatimin e Planit Vjetor të miratuar nga Ministri i Financave për vitin 2014, si dhe rregullave ligjore në fuqi për rialokimin e burimeve të planifikuara me kërkesë të menaxhimit.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, ka zhvilluar veprimtarinë audituese bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet në fuqi, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës. Me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të riskut, në përputhje me fushën për auditim. Secili proces auditues, është realizuar bazuar mbi Planin e Auditimit i detajuar për çdo fushë auditimi, në përputhje me objektivat që drejtimi dhe grupi i punës ka caktuar për secilin mision, si dhe në përputhje me natyrën e subjektit të planifikuar për t'u vënë nën auditim.

Gjetjet e auditimit

Natyra e gjetjeve të auditimit i referohen kryesisht:

- Mashtrimeve në administrimin e fondeve publike.
- Shpërdorim i fondeve të shoqërive tregtare me pronar shtetin.
- Abuzimeve me fondet publike të prokuruar.
- Rrezikut fiskal nga sistemi i pasigurtë i IT-së për tatimet.
- Shkelje me pasoja të rënda financiare për buxhetin në procedurat e huamarrjes publike.
- Abuzimeve me zbatimin e procedurave të pagesave nga llogaria e qeverisë.
- Parregullsi në zbatimin e procedurave të përdorimit të fondit rezerve të qeverisë.
- Sistemi i dobët i Kontrollit të brendshëm për menaxhimin e borxhit publik.
- Zhvillimit të veprimtarisë në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fusha të caktuara.
- Dobësive të sistemit të Kontrollit të Brendshëm.
- Abuzimeve me përdorimin e karburantit.
- Mos efience dhe mos zbatim i procedurave të investigimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.
- Parregullsive në menaxhimin financiar, ruajtjen e aseteve.
- Shkelje financiare në paga, sigurime, përdorim karburanti, etj.
- Shkelje procedurash duke ndryshuar destinacionin e fondeve për ngritje kapacitetesh pa asnjë njoftim miratim të përfituesit direkt.
- Shkelje procedurash në pagesat për udhëtim e dieta jashtë vendit.
- Shkelje financiare dhe rrezik për mashtrim fiskal me fondet e BB, duke kryer pagesa konsulenti jo në llogarinë e tij, por të personave të tjerë (dy raste)
- Parregullsi, shkelje dhe abuzime në sistemin tatimor, të shoqëruara me efekte të larta fiskale.
- Shkelje të procedurave të prokurimit duke mos ngritur njësi të përhershme prokurimi, mungesa të dokumentacionit në dosjet e prokurimit, keqpërdorim të fondeve të vëna në dispozicion.

Sipas njësive të audituara gjetjet janë adresuar si vijon:

- Shpërdorim, vjedhja, falsifikim dhe parregullsi në menaxhimin e buxhetit nga Agjencia e Auditimit të Fondeve të Asistencës Akredituar nga BE. Abuzim me rregullat e prokurimit publik, shkelje e barazisë në tendera dhe shmangie e procedurave të prokurimit, dhe falsifikim i tyre.
- Shpërdorim i fondeve të shoqërisë tregëtare me pronar shtetin, "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë", mbipagesa për shpërblime të pa autorizuar

nga organi kompetent/aksioneri, krijimi i stoqeve dhe bllokimi i likuiditetit në tenderim dhe blerje lëndësh të para edhe kur stoku gjendje mbulonte nevojat deri nëmbi 5-vjeçare. Shkelje dhe parregullsi të tjera të evidentuara si pasojë e menaxhimi të dobët të burimeve/asete publike.

- Shkelje me pasoja të rënda financiare për buxhetin në procedurat e huamarrjes publike, për kredinë sindikale, me pasojë blerjen e huasë më të shtrenjtë në treg për rreth 60 milionë Euro më tepër se sa oferta më e lirë e paraqitur, si pasojë e shkeljes së rregullave ligjore, dhe pabarazisë në trajtimin e konkurruesve ofertues.
- Sistem i dobët i kontrollit të brendshëm për menaxhimin e borxhit publik, mungesë manualesh, procedurash, etj, si për huamarrjen ashtu dhe nën-huamarrjen, si dhe shkelje të procedurave ligjore në fuqi për huanë e siguruar nga Fondi i Abu Dhabit për Zhvillim, me destinacion Bulevardin e Tiranës, e dhënë me nënhua për Bashkinë Tiranë, në shumën rreth 7.44 miliardë lekë.
- Abuzimeve me zbatimin e procedurave të pagesave nga llogaria e qeverisë me autorizim të ish drejtuesve të Ministrisë së Financave gjatë vitit 2013, nga veprimet e kryera nga 5 degë Thesari:Dibër, Elbasan, Delvinë, Gjirokastrë, Devoll, Ersekë duke shkelur radhën e pagesave në favor të disa operatorëve ekonomike dhe diskriminim të të tjerëve në radhë.
- Shkelje të procedurave në përdorimin e fondit rezervë të qeverisë, për të mbuluar pagesa të pa qarta, nga Këshilli i Ministrave dhe të pa argumentuara për t'u mbuluar ky fond nga buxheti i shtetit.
- Parregullsi në treguesit e pasqyrave fiskale, lidhur me mos paraqitjen me vërtetësi të të ardhurave nga privatizimi, dhe as atyre nga TVSH-ja, në Ministrinë e Financave.
- Mos zbatim i rregullave të investigimit të raportimeve nga bankat, për rastet që i takojnë personave të përfshirë në transaksionet e lidhura me skemën e mashtrimit me TVSH-në, në fushën e luftës kundër parandalimit të pastrimit të parave.
- Shkelje të rregullave financiare në përdorimin e buxhetit, kryerjen e pagesave dhe menaxhimin e karburantit nga ILDKP, audituar nga kjo njësi auditimi sipas marrëveshjes dypalëshe.
- Abuzim me përdorimin e karburantit në Drejtorinë e Shërbimeve të Ministrisë së Financave.
- Shkelje procedurash, ndryshim i destinacionit të fondeve, shkelje procedurash në pagesat për udhëtim e dieta jashtë vendit, shkelje financiare dhe rrezik mashtrimi fiskal duke kryer pagesa konsulenti jo në llogarinë e tij, por të personave të tjerë (dy raste), dhe amendime kontratash me

çmime deri nëmbi dy herë më të larta nga kontrata bazë (në 1 rast), etj nga Drejtoria e Financimeve dhe Kontraktimeve të fondeve të huaja.

- Parregullsi, shkelje dhe abuzime në procedurat tatimore, të shoqëruara me efekte të larta fiskale. Deklarime të pa sakta, mosrakordime të treguesve të deklaruar me ato të sistemit informatik, etj., në DRT Fier.
- Shkelje të procedurave të prokurimit dhe kryerje prokurimesh pa ngritur njësi të përhershme prokurimi, mungesë të dokumenteve të prokurimit, keqpërdorim i fondeve në dispozicion, kryerje prokurimesh të drejtpërdrejta në mënyrë të pa arsyetuar sipas ligjit duke shmangur konkurimin, si dhe blerje e disa shërbimeve IT të cilat ofrohen pa pagesë nga AKSH, etj. në Ministrinë e Financave.
- Të tjera të detajuara sipas Formatit 3, bashkëlidhur Raportit.

Një pjesë e zbulimeve janë raportuar si dyshime për vepra penale, të tjera janë raportuar si kosto të pa lejueshme/efekte financiare të ngarkuara për çdëmtim, si dhe të tjera si parregullsi dhe dobësi të sistemit të operacioneve të punës dhe të drejtimit, etj. Të gjitha gjetjet i janë raportuar menaxhimit, së bashku me rekomandimet përkatëse, dhe janë marrë masat për verifikimin e zbatimit të tyre.

Cilësia e raportimit të auditimit

Drejtoria është përqendruar, në respektimin e Standarteve të Raportimit për Auditimin e Brendshëm me qëllim hartimin e raporteve të besueshme, koncize, të sakta, të bazuara në fakte, dhe mbi të gjitha të vlefshme në ndihmë të menaxhimit për përmirësimin e punës dhe rritjen e eficiencës së operacioneve financiare dhe të drejtimit. Rritja e cilësisë së raportimit do të vijojë të jetë prioritet dhe nën monitorim sistematik.

Raportet janë hartuar në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të Udhërrëfyesit specifik. Janë respektuar standardet në fushën e raportimit për sa i përket përmbatjes, cilësisë, qartësisë dhe dobishmërisë së kësaj faze të procesit auditues.

□ Burimet e auditimit

Burimet e auditimit janë alokuar në mbështetje të Planit vjetor të vitit 2014, mbi të cilin është kryer rialokimi i tyre gjatë vitit, (në rastin e kërkesave të menaxhimit).

Është konsideruar i rëndësishëm kompozimi i grupeve të auditimit në përputhje me natyrën e

njesisë nën auditim si dhe vlerësimin e kapaciteteve profesionale në dispozicion.

Për 2014, burimet njerëzore të auditimit në dispozicion kanë qenë 5 nga 7 të planifikuara për 10 muajt e parë, ndërsa në 2 muajt e fundit janë shtuar me 1 auditues.

I gjithë stafi auditues është i certifikuar, si dhe i është nënshtruar trajnimit të vijueshëm. Janë paraqitur në vijim dy nga treguesit e përdorimit të burimeve të auditimit.

Zbulime në vlerë/një auditues (mln lekë/1 auditues)
sipas 12 mujorëve në vite.

<i>Treguesit</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>
<i>Auditues</i>	7	7	8	6
<i>Zbulime në 000 lekë</i>	154.35	191.6	1,428.1	16,682.8
<i>Zbulime në 000 lekë/auditues</i>	22	27.3	178.6	2,780.4

Konstatohet rritje e lartë me rreth 15.5 herë e forcës zbuluese për çdo auditues në vitin 2014, çka ka ardhur për shkak të përmirësimit të performancës së stafit, edhe pse numri i tij është ulur, por edhe për shkak të zbulimeve të larta në dy auditime, të cilat kanë ndikuar kryesisht në këtë tregues. Pavarësisht nga kjo, vihet re lehtësisht tendenca pozitive në rritje e zbulimeve për çdo staf nga viti në vit.

□ **Objektivat për vitin 2014. Niveli i realizimit të tyre**

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm ka hartuar objektivat afatgjatë të shprehura në Planin Strategjik 2014-2018, si dhe objektivat afatshkurtër të vitit 2014, niveli i realizimit të cilave, paraqitet në vijim;

Angazhimet	Rëndësia	Afati	Komente/ rreziqe	Rezultati
Të pranohen dhe zbatohen 100% rekomandimet e auditimit nga subjektet e audituara. Plani i auditimeve të realizohet 100% ,si dhe 80% e stafit të angazhohet në auditime të plota.	Kontribut në shtimin e vlerës së institucioneve publike, dhe përmirësimin e drejtimit të tyre, për financa publike të shëndetëshme	30 /06/14 31/12/14	Ka kufizim sasior dhe cilësor në burime njerëzore.	96.1% të pranuar, nga stafet sipas fushave, 100% të pranuar nga drejtimi
Të rritet me 3 % forca zbuluese duke shmangur auditimet rutinë dhe që kanë kosto të pa justifikuar auditimi.	Rritje e efikasitetit të shërbimit në luftën kundër korrupsionit	30/06/14 31/12/14	Kërkon rritje të kompetencës së stafit. Auditime të zgjedhura gjëreshisht në nivelin 80% mbi bazë risku	Tejkaluar. Zbulimet janë rritur me 15.5 herë Raport i fundit të vitit
Të hartohet një Manual për procedurat e	Rritje e cilësisë së punës audituese për	30 /06/14	Si dokument i nevojshëm do të rregullojë	Hartuar drafti.

rishikimin e brendshëm të cilësisë së auditimeve përpara raportimit të rezultateve.	produkte të dobishme në shërbim të përmirësimit të menaxhimit të sektorit të Financave publike.		procedurat e vlerësimit, për të shmangur raportime të pa sakta e të pa dobishme.	
Të kryhen 16 orë trainim i stafit bazuar në nevojat për trajnime të specifikuar për çdo anëtar të stafit.	Rritje e profesionalizmit të administratës publike	Brenda Qershorit 2014	Plan trajnimit bazuar në nevojën individuale të secilit anëtar të stafit.	Tejkaluar me mbi 40 orë/staf
Të bëhet publikimi, përveç raportimeve periodike dhe vjetore në faqen e Ministrisë së Financave , edhe i një analize kosto-përfitim të këtij shërbimi.	Rritje e transparencës	30/09/14	Konsiderohet tregues performancë dhe i jep mundësi publikut të gjykojë mbi efektivitetin e këtij shërbimi.	I realizuar si pjesë e raportit vjetor.
Të hartohen termat specifike dhe të kryhet trajnim në fushën e komunikimit, për rregullat bazë të komunikimit.	Rritje e efikasitetit dhe dobishmërisë së komunikimit në vendimmarrje	30 /10/14	Të adresohen raporte të dobishme që plotësojnë kriteret e raportimit.	Janë hartuar Janë objekt rishikimi në vijimësi